




RAPORT MONITORIMI

ENERGJIA


Maj-Korrik 2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

TRANSPARENCA



AUTOR
Ergisa Bejkollari

QENDRESA
QYTETARE



National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom around the World

www.qeverisja.qq.com.al



Përmbajtje

Parathënie nga autorja	2
Nga liberalizimi i tregut të energjisë tek Plani Strategjik për Energjinë 2018-2030	2
Fazë 1: Ristrukturim/ ndarje OSHEE	4
Ndarja ligjore	5
Ndarja financiare	5
Fazë 2: Listimi	7
Kriteret që një entitet duhet të plotësojë për t'u regjistruar pranë ALSE janë si më poshtë:	7
Cilat janë përfitimet që vinë nga listimi në bursë i entiteve publike?	8
Cilat janë palët e interesuara për listimin e entiteve publike në bursë?	9
Gjetjet kryesore	9
Rekomandimet kryesore	9



Parathënie nga autorja

Zhvillimet në sektorin e energjisë, edhe për shkak të natyrës së tyre teknike, shpeshherë shpëtojnë nga vëmendja e e mediave dhe publikut. Publikimet e institucioneve të linjës dhe daljet në media nuk mjaftojnë për një edukim ezaurues e përmbajtësor të atij që mban në këmbë institucionet e një shteti demokratik: taksapaguesit shqiptar.

Ky raport sjell një panoramë të përgjithshme të ndryshimeve dhe reformave kryesore që janë ndërmarrë 5 vitet e fundit në tregun e energjisë. Nëpërmjet analizimit të fakteve, deklaratave, progres-raporteve dhe publikimeve në media e në fletoren zyrtare, synohet të drejtohet vëmendja tek disa prej çështjeve që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, interesin publik.


Raporti ndërton fillimisht kontekstin mbi të cilin janë ndërmarrë reformat që prej vitit 2014 e në vijim. Por, fokusohet veçanërisht tek ristrukturimi i OSHEE dhe listimi në bursë i saj. Kjo e fundit duhet parë si një hap fillestar e thelbësor drejt asaj që më vonë mund të zhvillohet si praktikë e zakonshme: bursimi i entiteve publike është padyshim një mjet që ndihmon shumë palë, por mbi të gjitha ndihmon vetë entitetet në procesin e transparencës dhe llogaridhënies para taksapaguesit të shndërruar tashmë në aksioner.

Autorja, nëpërmjet raportit, nuk shpërfaq mendimin e saj personal, por një analizë të të gjithë elementëve sjellë sëbashku në kontekstin e së tashmes.

Nga liberalizimi i tregut të energjisë tek Plani Strategjik për Energjinë 2018-2030

Viti 2014 dhe Samiti i Vjenës i mbajtur një vit më vonë, shënuan një kthesë të rëndësishme për sektorin e energjisë në Shqipëri, duke i hapur rrugë strategjive për vitet e ardhshme: liberalizimin e tregut dhe planin e ri të energjisë, njoftuar tre vite më vonë. Nisën kështu përpjekjet me qëllimin ambicioz të transformimit tërësor të sektorit të energjisë në rajon.

Së bashku me vendet e tjera të rajonit, Maqedoni, Serbi, Bosnje & Hercegovinë dhe Kosovë, tashmë Shqipëria do duhej të merrte një sërë masash në sektorin energjistik, të cilat në asokohe u konsideruan “të buta”, por koha tregoi se bëhej fjalë për më shumë se kaq. Me miratimin e ligjit në



prill të vitit 2015¹, nisën ecejaket për atë që prej 6 vitesh e quajmë “reformimi i tregut të energjisë”, që përfshinte liberalizimin, një plan të ri për energjinë e shumë elementë të tjerë.

Qëllimi kryesor i liberalizimit si proces është padyshim rritja e konkurrencës, reduktimi i ndërhyrjes së shtetit në sektor, rritja e ofertës, përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe zhvillimi i sektorit në tërësi. Specifikisht, në sektorin e energjisë, ky qëllim synohet të arrihet nëpërmjet ndarjes së funksionit të furnizimit nga funksioni i shpërndarjes së energjisë elektrike. Në praktikë, kjo do të thotë që KESH tashmë “çlirohet” nga funksioni si furnizues i energjisë, për t’ua kaluar këtë përgjegjësi operatorëve privatë që do të licencohen në bazë të disa kriterëve. Duke qenë se KESH do të ketë si funksion primar prodhimin e energjisë, kjo sjell një sërë përfitimesh si shtimin e kapaciteteve prodhuese, përmirësimi i shërbimit etj.

Një tjetër synim është dhe mbrojtja e konsumatorëve. Nga një sistem monopolistik ku funksionet i kryente KESH, tashmë drejt konkurrencës thuajse të plotë që shoqërohet me përmirësimin e cilësisë, të kushteve teknike dhe operacionale, efienca dhe çmime të arsyeshme. Këshilltari për rritje ekonomike pranë USAID, Theodore P. Heisler, në vitin 2017, shprehej se liberalizimi i tregut mundëson gjithashtu investimet në infrastrukturën e energjisë.²

Në kuadër të liberalizimit, procedurat më të rëndësishme janë: Kompanitë të cilat do të ofrojnë shërbimin e furnizimit do të regjistrohen dhe licencohen nga ERE sipas disa kriterëve dhe çmimeve të rregulluara. Ndërsa, konsumatorët do të regjistrohen si të tillë nga OSHEE.

Në vijim të reformimit të tregut, kryeministri Rama njoftoi në mars të vitit 2018 dhe Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018–2030³: “Shpresoj që deri në fund të këtij viti të jemi gati që tu ofrojmë qytetarëve shqiptarë mundësinë e pjesëmarrjes si aksionere me qëllim që vitin e ardhshëm kompania të kthehet në një kompani ku pjesëmarrja masive e qytetarëve si aksionerë do të ketë një benefit reciprok”, tha Kryeministri. “Shkalla e hapjes së tregut të energjisë elektrike të arrijë 100% në vitin 2025”, vazhdoi më tej.

Në vendimin e Këshillit të Ministrave, datë 31 mars 2018, prioritetet dhe veprimet e sektorit të energjisë sa i përket operatorëve publikë janë si në tabelën më poshtë:

¹ https://infrastruktura.gov.al/ep-content/uploads/2017/10/ligj_nr_43_dt_30_4_2015_22652_1.pdf

² <https://aab-edu.net/media/gazetaknn/liberalizimi-tregut-te-cmimeve-energjetike-prej-1-prillit/>

³ https://ee.infrastruktura.gov.al/ep-content/uploads/2018/11/Vendim-i-KM_480_31.07.2018.pdf

Korporata Elektroenergjetik e Shqiptare (KESH)	<ul style="list-style-type: none"> - Forcimi i kapaciteteve të reja (sidomos në lidhje me tregtimin e energjisë), në kushtet kur KESH-i do të duhet të shesë energji dhe të konkurrojë në tregun e ri; - Mosndërhyrja në çmimet e prodhimit dhe përfundimi i kontratës së plotë të furnizimit me OSHEE-në; - Rritja e kapacitetit të saj gjenerues duke u bërë një lojtar kyç në rajon
Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)	<p>Përgatitja e llogarive të ndara për OST-në dhe funksionet e operatorit të tregut të OST-së;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e rregullave për sigurinë e rrjetit, cilësinë e furnizimit dhe procedurat për lidhjet e reja; - Finalizimi i rregullave të tregut, duke përfshirë rregullat për ndarjen e ndërlidhjes ndërkufitare ose kapaciteteve; - Përgatitja e parashikimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të kërkesës për energji elektrike; - Përgatitja e një plani zhvillimor dhjetëvjeçar për Shqipërinë dhe sigurimi i përditësimeve të planit vjetor të investimeve së bashku me aplikimet vjetore të tarifave; - Rekrutimi dhe trajnimi i stafit për të operuar dhe për të vendosur tregun në përputhje me direktivat.
Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE)	<p>Vazhdimi i investimeve për të ulur më tej humbjet e shpërndarjes dhe për të përmirësuar normat e arkëtimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e rregullave për sigurinë e rrjetit, cilësinë e furnizimit dhe procedurat për lidhjet e rrjetit; - Përgatitja e një plani 5-vjeçar të zhvillimit për rrjetin e shpërndarjes dhe sigurimi i përditësimeve të planit vjetor të investimeve së bashku me aplikimet tarifore vjetore; - Përcaktimi i roleve të reja, që do të merren përsipër në kuadër të zbatimit të modelit të ri të tregut, për shembull në menaxhimin e KpD-ve me gjeneruesit privatë; - Kompletimi i ndarjes ligjore dhe operacionale të funksioneve të shpërndarjes dhe furnizimit brenda vitit 2018; - Ndërtimi i aftësive operacionale për të kryer përgjegjësitë sipas modelit të ri të Tregut.

Tabela 1. Prioritetet dhe veprimet e sektorit të energjisë – operatorët publikë

Pra, shohim nga tabela e mësipërme që një nga detyrat kryesore të OSHEE është ndarja: ligjore, operacionale dhe financiare. Për të theksuar më tepër rëndësinë e ristrukturimit të OSHEE, në Vendimin e Këshillit të Ministrave theksohej:

“Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe OSHEE-ja po punojnë për të ndarë rrjetin e shërbimit të shpërndarjes nga Furnizuesi i Shërbimit Universal të konsumatorëve tariforë. Ndarja e OSHEE-së është një detyrim sipas acquis së Komunitetit të Energjisë dhe ligjit për sektorin e energjisë, i cili do të krijojë më shumë transparencë për të gjithë përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes.”

Fazë 1: Ristrukturim/ ndarje OSHEE

Në vijim të ristrukturimit të OSHEE parashikohej ndarja ligjore, ndarja financiare dhe më pas listimi në bursën ALSE të njërit prej entiteteve.

Ndarja ligjore

Në 30 mars të vitit 2018, OSHEE njoftoi ndarjen ligjore si hapin e parë duke regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit tre kompanitë e reja:

- 1- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, shoqëri e themeluar në datë 28.03.2018, me seli në Tiranë dhe me kapital 3.500.000 lekë. Veprimtaria e kompanisë përfshin shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtja e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve, lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike etj.
- 2- Furnizuesi i Tregut të Lirë, sh.a shoqëri e themeluar në datë 28.03.2018, me seli në Tiranë dhe me kapital themeltar në vlerën 3.500.000 lekë. Veprimtaria e FTL përfshin blerjen dhe menaxhimin e energjisë dhe operimin në tregun e lirë etj, si dhe cdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë. Për më tepër Shoqëria mund të kryejë cdo aktivitetet tjetër i cili nuk është i ndaluar nga ligji në fuqi.
- 3- Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a e themeluar në datë 28.03.2018, me seli në Tiranë dhe me kapital themeltar në vlerën 3.500.000 lekë. Aktiviteti i Shoqërisë do të konsistojë në: furnizimin me energji elektrike

të klientëve fundorë që veprojnë në treg të rregulluar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, ofrimin dhe sigurimin e cilësisë tregtare të shërbimit, si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë.

Ndarja financiare

Ndërkohë që, për të finalizuar të gjithë procesin do të nevojitet pikërisht ndarja financiare, ndarja e asetëve dhe ndarja efektive që disponon kompania për të vijuar më pas me listimin në bursë të njërës prej entiteve, FSHU-së.

Në shtator të vitit 2018, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike parashikoi hapjen e një tenderi me objekt inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve materiale afatgjata, një procedurë që i hap rrugën ndarjes financiare të kompanisë si dhe më tej, listimin në bursën ALSE të njërës prej kompanive.⁴

Afati i përcaktuar për ndarjen e kompanisë u vendos dhjetori i vitit 2020 ndërkohë që moszbatimi i tij në kohë u evidentua dhe nga progres-raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2020.⁵


Shkëputur nga Raporti i KE-së në lidhje me energjinë (5.15. Kapitulli 15: Energjia, fq 97/148)

Politikat e BE-së për energjinë mbulon furnizimin me energji, infrastrukturën, tregun e brendshëm të energjisë, konsumatorët, energjinë e rinovueshme, efikasitetin e energjisë, energjinë bërthamore dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi. Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në këtë fushë. Ka pasur disa përparime në sektorët e energjisë së rinovueshme dhe të gazit, si dhe në linjat e interkonjeksionit. Megjithatë, rekomandimet e vitit të kaluar janë plotësuar vetëm pjesërisht me ndarjen e operatorit të sistemit të shpërndarjes OSHEE sh.a.

Planet për krijimin e një fondi jo të detyrueshëm për efikasitetin e energjisë janë braktisur. Vendi ka vonuar përsëri reformat në tregun e energjisë elektrike. Zbatimi i masave të reformës së konektivitetit duhet të përshpejtohet, veçanërisht përmes heqjes së pengesave ligjore dhe kontraktuale për integrimin e tregjeve të energjisë.

⁴ <http://energjia.al/2018/09/06/listimi-i-oshee-ne-burse-kompania-hap-tender-per-ndarjen-financiare>

⁵ <http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/63-progres-raportet>



Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet veçanërisht: → të diversifikojë më tej prodhimin e energjisë elektrike përveç burimeve hidrike dhe të promovojë burime alternative të energjisë së rinovueshme duke respektuar standardet mjedisore dhe të krijojë një treg të organizuar të energjisë elektrike të ditës paraardhëse; → **të përfundojë ndarjen ligjore dhe funksionale të ndërmarrjeve të energjisë dhe shfuqizojë pengesat ligjore për të drejtën e klientëve për të ndryshuar furnizuesin e tyre të energjisë elektrike**; → të përafrojë plotësisht ligjin “Për eficientësin e energjisë” me acquis dhe të miratojë legjislacionin zbatues në lidhje me Direktivën e performancës së energjisë së ndërtesave.

“Në lidhje me tregun e brendshëm të energjisë, ndarja e detyrueshme e vetë OST-së nuk u arrit në afatin e përcaktuar në dhjetor, pavarësisht ndarjes së plotë të pronësisë së Korporatës Energjetike Shqiptare (KESH sh.a.) nga operatori i sistemit të transmetimit OST sh.a. Në qershor të vitit 2020 hyri në fuqi ligji i ndryshuar për sektorin e energjisë. Këshilli i Ministrave miratoi disa akte zbatuese që krijojnë bazën ligjore për ngritjen e operatorit të tregut dhe krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë (APEX). Mbledhja e parë e Komitetit Drejtues të APEX-it u mbajt në tetor. Një komision i posaçëm u ngarkua me përgatitjen e përzgjedhjes së aksionarëve. Procedura u ngadalësua edhe për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. **Autoriteti Rregullator i Energjisë (ERE), me një vendim të tij e shtyu përfundimin e ndarjes funksionale deri më 29 qershor 2020. Që nga 1 janari 2020 ka përfunduar ndarja ligjore dhe funksionale e operatorit të sistemit të shpërndarjes OSHEE sh.a. nga aktiviteti i saj i furnizimit. Tre kompani të reja përgjegjëse për shpërndarjen e energjisë elektrike, furnizimin universal dhe furnizimin e tregut të lirë, por ndarja efektive është ende pezull për shkak të vonësive në transferimin e aktiviteteve, aseteve dhe stafit të kompanitë e reja.** Çmimet e energjisë elektrike janë ende të rregulluara, por duhet të liberalizohen gradualisht pas zbatimit të legjislacionit. E drejta e klientëve për të ndërruar furnizuesit parandalohet në mënyrë efektive për shkak të ndryshimeve në ligjin “Për sektorin e energjisë”; zbatimi ende mungon pasi të gjithë klientët e kualifikuar, përveç atyre të lidhur me tensionin e lartë, mund të furnizohen me çmime të rregulluara nga OSHEE (si furnizuesi i mundësisë së fundit) për dy vjet. Si rezultat, të gjithë klientët e shpërndarjes, me përjashtim të disave të lidhur në rrjetin 35kV, efektivisht mbeten nën furnizimin e rregulluar. Tregu i energjisë elektrike dominohet nga një kontratë e rregulluar ndërmjet ndërmarrjeve shtetërore të prodhimit dhe të furnizimit. Kjo kontratë duhet të zgjidhet urgjentisht.

Duke e rimarrë çështjen në një intervistë të janarit 2021⁶, Adrian Çela, Administrator i OSHEE Group, rishprehu se për vitin 2021, OSHEE parashikon

⁶ <https://ëëë.monitor.al/nga-ulja-e-humbjeve-te-matesit-inteligjente-planet-e-oshee-se-ne-2021-2/>

dhe konsolidimin e ndarjes së Shoqërisë në 3 Operatorë, dhe përgatitjen për hapat e mëtejshëm të liberalizimit të tregut.

Qëndresa Qytetare iu drejtua me një kërkesë zyrtare për informacion OSHEE-së, sa i përket fazës në të cilën ndodhet procesi i ndarjes, për të cilën nuk mori një përgjigje.

Fazë 2: Listimi

Procesi i konsolidimit të ndarjes së OSHEE është veçanërisht i rëndësishëm pasi i paraprin një tjetër procesi tepër të rëndësishëm, siç është listimi i njërës prej entiteve në bursë.


Në strategjinë kombëtare të miratuar në vitin 2018, jepen ndër të tjera detaje për atë që është folur shumë shpesh rreth listimit të OSHEE në bursë. *“Për të shkuar drejt kësaj duhej që fillimisht sipas qeverisë të bëhet ristrukturimi i plotë i shpërndarjes që ka nisur nga marsi 2018. Ndarja ligjore e OSHEE-së si dhe ndarja e plotë funksionale sipas dokumentit do të zbatohen sa më shpejt që të jetë e mundur, brenda periudhës së parë. Kjo do të përfshijë marrëveshjet përfundimtare dhe operacionale midis të gjitha kompanive të reja, duke përfshirë, por jo kufizuar në, ndarjen e asetëve, shpërndarjen e pagesave të prapambetura dhe borxhet mes kompanive të ardhshme.”⁷*

“Do të përmbajë gjithashtu një strategji për ofertën publike, potencialisht që do të çonte në një privatizim të plotë të kompanisë furnizuese me një investitor strategjik që lehtësonte zbatimin e transformimit në një kompani biznesi private dhe konkurruese dhe një ofertë të pjesshme për publikun shqiptar për një pjesë minoritare të kompanisë DSO (operatori i sistemit të transmetimit), me Këshillin e Ministrave të Shqipërisë duke ruajtur kontrollin mbi biznesin e rregulluar” thuhet në plan.

Sipas informacioneve pranë Bursës Shqiptare të Titujve (ALSE), nuk ka patur ende një interesim nga ana e OSHEE për procesin e listimit dhe për kriteret që duhen plotësuar.

Në një tjetër deklaratë të Entela Çipa, në rolin e saj si këshilltare e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjijnuri, u risoll në vëmendje fakti se për të realizuar listimin e OSHEE-së në bursë, duhet që fillimisht të përfundojë ndarja e kompanisë.

⁷ <https://ëëë.monitor.al/si-do-kryhet-listimi-i-oshee-ne-burse-furnizuesi-do-i-shitet-nje-investitori-strategjik/>



Renditja e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në bursë është një opsion që është diskutuar edhe me bankat, sikurse është Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Botërore, por për të realizuar listimin në bursë duhet që fillimisht të përfundojë ndarja e kompanisë. Aktualisht ka përfunduar vetëm ndarja ligjore e OSHEE-së, ndërkohë që duhet të përfundojë ndarja e asetëve dhe ndarja financiare. Më pas do të shikohet se cila prej këtyre 3 kompanive do të zgjidhet për t'u listuar në bursë. Duhet thënë se është e domosdoshme kryerja e studimeve në këtë drejtim për të përcaktuar se cila prej tyre mund të listohet. Ky studim besoj se do të kryhet nga KFW, BERZH dhe BB, duke qenë se edhe interesi fillestar është shprehur prej tyre e që kanë dhënë aktualisht kredi në sektor.¹

Kriteret që një entitet duhet të plotësojë për t'u regjistruar pranë ALSE janë si më poshtë:⁸

- 1- Një kapital fillestar mbi një million euro
- 2- Vlerë emetimi më e madhe se një vlerë e caktuar
- 3- Në rastin e shitjes së aksioneve, duhet të jetë për një vlerë më të madhe se 15% e tyre
- 4- Jetëgjatësia e biznesit më e madhe se 3 vjet kur gjatë 2 viteve të fundit, kompania duhet të rezultojë më fitim.
- 5- Duhet të zhvillojë një proces të rregullt auditimi të jashtëm nga njëra prej kompanive që operojnë në Shqipërië (të njohura ndryshe si "Big Four").
- 6- Letrat me vlerë duhet të jenë të regjistruara në një regjistër të letrave me vlerë.

Nisur nga kriteri i tretë dhe i katërt, mund të deduktojmë që bursimi i OSHEE do rriste mbi të gjitha transparencën financiare ndaj publikut duke përmirësuar ndjeshëm procesin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies para taksapaguesve dhe në këtë rast, aksionerëve direkt.

⁸ <https://alse.al/ëp-content/uploads/2017/12/ALSE-Rregullorja-e-Burses-Shqiptare-te-Titujve.pdf>

Cilat janë përfitimet që vinë nga listimi në bursë i entiteve publike?⁹¹⁰

- 1- Rritja e Kapitalit – Bursa konsiderohet si një ndër mënyrat më të lira të financimit të aktivitetit të biznesit. Listimi i titujve në bursë realizohet kryesisht nëpërmjet të ashtu quajturave Oferta Publike Fillestare (IPOs) të cilat i mundesojnë biznesit të ftojë publikun të investohet në titujt e tij në këmbim të performancës financiare të lartë dhe me norma të pritshme kthimi që tejkalojnë riskun e ndërmarrë nga investitorët.
- 2- Krijimi dhe sigurimi i një tregu të përhershëm – në të mund të blihet dhe të shitet në cdo kohë një titull i caktuar.
- 3- Ekzistenca e Bursës si vend takimi – në të bëhet përputhja e shpejtë për përmbushjen në kohë dhe në sasi të kërkesave dhe ofertave për tituj.
- 4- Transaksionet ekzekutohen me kosto minimale – bursa regjistron të gjitha tregtimet aq shpejt, sapo ato ekzekutohen. Sistemi elektronik i tregtimit realizon shfaqjen në kohë reale të numrit të aksioneve të ekzekutuara dhe cmimin e tyre të tregtimit.
- 5- Çmime reale e transparente – çmimet vendosen sipas parimit të kërkes-ofertës dhe në përputhje me rregullat e tregtimit të bursës.
- 6- Vlerësim real të vlerës së tregut – përcaktimi i cmimeve reale mundëson edhe vlerësimin real të vlerës së tregut të subjektit emetues (çmim x sasi titujsh = vlera reale e tregut).
- 7- Prestigj – për shkak të kuotimit të shpeshtë të cmimeve të titujve dhe mediatizimit të këtyre transaksioneve financiare, listimi i titujve në një bursë konsiderohet edhe si prestigj për subjektin emetues. Kjo për shkak se në bursë listohen vetëm subjekte që plotësojnë një seri kriteresh rigorozë cilësore dhe sasiorë. Ka raste kur edhe pse nuk kanë nevojë për fonde të lira për rritjen e volumit të biznesit, subjekte të ndryshme preferojnë të listohen në Bursë duke e konsideruar atë si etalon të korrektesës financiare dhe standardizimit të transparencës financiare e institucionale.
- 8- Listimi në Bursën Shqiptare i këtyre kompanive, do të rriste nivelin e transparencës financiare dhe reduktonte mundësinë e abuzimit me fondet publike nëpër këto kompani.
- 9- Listimi i korporatave shtetërore shkon në linjë me politikën e Qeverisë (dhe çdo qeverie) për luftimin e evazionit fiskal, e këtu Shteti jep shembullin e vet të parë duke listuar korporatat që ka nën pronësi.

⁹ https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Bursa_Shqiptare_e_Titujve_ALSE

¹⁰ <http://ëëë.scan-tv.com/perfitimet-e-obligacioneve-te-kompanive-publike-listimi-i-kompanive-publike-ne-burse-do-te-rriste-edhe-nivelin-e-transparences-financiare-scan-magazine/>



10-Listimi i këtyre korporatave shtetërore, do të rriste ndjeshëm vlerësimin e Shqipërisë në renditjen e raportit Doing Business 2020 që për gatit Banka Botërore.

Cilat janë palët e interesuara për listimin e entiteve publike në bursë?

- 1- Një nga palët e interesuara në këtë proces është ministria e linjës, duke qenë se bursimi është një mënyrë për të rritur efikasitetin operative dhe financiare të kompanisë, bën më të lehtë procesin e transparencës ndaj palëve të tjera të interesuara dhe konsiderohet si një investim pozitiv afatgjatë.
- 2- Institucioni rregullator, në rastin konkret ERE. Listimi në bursë dhe si pasojë rritja e llogaridhënies, lehtëson në vetvete punën e entit rregullator.
Qëndresa Qytetare, në një kërkesë zyrtare për informacion, u interesua pranë ERE në lidhje me qëndrimin e kësaj të fundit rreth listimit të OSHEE në bursë. Por, përgjigja i referohej vetëm punës së bërë në lidhje me Bursën Shqiptare të Energjisë.
- 3- Një përfitim tjetër shkon dhe për individët investues, pasi në këtë mënyrë rriten opsionet për diversifikimin e portofolit të investimeve. Duhet theksuar se aktualisht për një investitor individ, tregu në Shqipëri ofron pak mundësi investimi: depozitat bankare dhe fondet private të pensionit.
- 4- Tjetër përfitues janë dhe kompanite e mëdha që operojnë në vend, të cilat gjithashtu kanë një interes financiar në diversifikimin e portofolit të tyre investues.

Gjetjet kryesore



OSHEE nuk ka publikuar një informacion të qartë dhe transparent për mbi ndarjen e saj në 3 operatorë të ndryshëm sic parashikohet në vendimin e Këshillit të Ministrave, datë 31 mars 2018.



Ristrukturimi i OSHEE, nuk është kryer brenda afateve të paracaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, datë 31 mars 2018, i cili vendoste vitin 2018 si datë përfundimtare.



Bursimi i OSHEE ose entiteteve të saj pas ndarjes rrit transparencën, kapitalin dhe sigurinë në treg, ashtu siç kanë treguar praktikantët në vendet e tjera të rajonit dhe opinioni ekspertëve të bursave. Megjithatë, asnjë nga institucionet e mëdha nuk ka bërë përpjekje drejt këtij objekti. Njësoj si znj. Çipa, po në vitin 2018, kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, deklaroi se kompania e Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë është optimale për t'u listuar në bursë, duke rritur kapitalin. Tre vitë më vonë, mbetet ende një deklaratë.¹¹



Ligji ende pengon qytetarët/klientët të bëhen aksionerë të kompanive më të mëdha shtetërore, dhe si rrjedhojë pengon në hapjen, transparencën dhe eficiencën operacionale të tyre.



Asnjëri nga institucionet shqiptare nuk kanë aplikuar pranë ALSE në lidhje me procesin e bursimit, duke treguar një mungesë vullneti për një proces, që sipas përfitimeve të mësipërme, është me interes për shumë palë.

¹¹ <http://ëëë.scan-tv.com/kompanite-shtetere-ne-burse-listimi-i-aksioneve-te-oshee-apo-ukt-avantazhet-mbi-privatizimin-strategjik/>

Rekomandimet kryesore



OSHEE duhet të rrisë nivelin e transparencës dhe informacionit lidhur me konsolidimin e ndarjes së saj dhe bursimin. Të dyja proceset janë të rëndësishme për taksapaguesit, megjithatë përpjekje të mëdha duhet të bëhen që listimi në bursë të mos mbetet vetëm një deklaratë për shtyp.



Listimi në bursë i kompanive më të mëdha shtetërore nuk duhet parë si një utopil, as nga ana e institucioneve dhe as nga ana e palëve të tjera të interesuara. Megjithatë, iniciativa fillestare sigurisht që duhet të vijë nga drejtuesit publikë, si pjesë e përgjegjësive të tyre për transparencë dhe menaxhim optimal financiar/operacional.



Përpjekjet për një plan-projekt që nis me “skanimin financiar” të kompanive shtetërore, duhet konsideruar me seriozitet dhe prioritet. Aktualisht, taksapaguesi shqiptar, ka pak ose aspak mjete në dispozicion për të kontrolluar ku shkojnë kontributet tatimore dhe si menaxhohen ato.

#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE



www.qeverisja.qq.com.al

RAPORT MONITORIMI
INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA
Maj-Korrik 2020